



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.182

dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.917, datë 28.12.2011	Për miratimin e planveprimit kombëtar “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të veprave të artit e të kulturës”	10193
Vendim i KM nr.922, datë 21.12.2011	Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave	10204
Vendim i KM nr.923, datë 21.12.2011	Për përbërjen, funksionimin e detyrat e Komisionit të Vlerësimit dhe Regjistrimit të Plehrave për Përdorim për Bimësinë, si dhe procedurat e hollësishme për regjistrimin e vlerësimin e tyre	10206
Vendim i ERE nr.138, datë 7.12.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë KESH sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012–2014	10211
Vendim i ERE nr.139, datë 7.12.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a. për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012–2014	10211
Vendim i ERE nr.140, datë 7.12.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hec Bistrice 1&2” sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2012	10212
Vendim i ERE nr.141, datë 7.12.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2012	10213
Vendim i ERE nr.142, datë 7.12.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hec Ulëz – Shkopet” sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2012	10213
Vendim i ERE nr.143, datë 7.12.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të “CEZ shpërndarje” sh.a. për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014	10214

Vendim i ERE nr.144, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore	10215
Vendim i ERE nr.145, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore.....	10216
Vendim i ERE nr.146, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore	10216
Vendim i ERE nr.147, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore.....	10217
Vendim i ERE nr.148, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore	10217
Vendim i ERE nr.149, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2012	10219
Vendim i ERE nr.150, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012	10219
Vendim i ERE nr.151, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “TEC Vlorë” sh.a., te furnizuesit publikë me shumicë për periudhën e tretë rregullatore	10220

VENDIM
Nr.917, datë 28.12.2011

**PËR MIRATIMIN E PLANVEPRIMIT KOMBËTAR “PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN
KUNDËR TRAFIKIMIT TË VEPRAVE TË ARTIT E TË KULTURËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planveprimit Kombëtar “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të veprave të artit e të kulturës”.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit, të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe institucionet e tjera shtetërore, të ngarkuara me detyra sipas këtij planveprimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANVEPRIMI KOMBËTAR
**PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË VEPRAVE TË ARTIT E
KULTURËS**

Tiranë, 2011

Hyrje

Fenomeni i vjedhjes dhe i trafikimit të veprave të artit e kulturës është një problem relativisht i vonë për vendin tonë, ku paralelisht me llojet e tjera të trafikëve, ka filluar të konstatohet pas viteve 1990.

Kontaktet me rrjetet kriminale të vendeve fqinje, bënë që elemente me prirje kriminale, në bashkëpunim edhe me persona me njohuri specifike në fushën e veprave të artit e kulturës, të përfshihen në aktivitetin kriminal të vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës, si një nga format e pasurimit të paligjshëm.

Dëmtimet më të mëdha të objekteve të trashëgimisë kulturore, u evidentuan në vitin 1997, si pasojë e vjedhjeve masive dhe shkatërrimit të pasurive kulturore në Shqipëri, nga elemente me prirje kriminale, për të përfituar në dëm të vlerave të pasurisë kulturore, duke shfrytëzuar dhe situatën e rëndë të sigurisë, të krijuar gjatë atij viti në vendin tonë.

Qeveria Shqiptare në programin e saj ka parashikuar si një nga prioritetet e punës, luftën kundër krimit të organizuar, ku përfshihet edhe lufta kundër trafikimit të veprave të artit e kulturës. Në këtë kuadër, hartimi i një plani kombëtar veprimi do të ndihmojë në një kundërvënie më efikase ndaj këtij fenomeni të paligjshëm e kriminal.

Ky planveprimi është hartuar në bazë të problematikës së evidentuar nga institucionet kombëtare përgjegjëse, për situatën e kërkimeve të paligjshme, vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit në Shqipëri.

Qëllimi i këtij plani është të harmonizojë përpjekjet e institucioneve përgjegjëse, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe njëkohësisht të adaptojë mjete e metoda ligjore më efikase, nga të gjitha institucionet kombëtare përgjegjëse, në luftën kundër vjedhjes e trafikimit të veprave të artit e kulturës.



Analizë

Shqipëria është një vend me pasuri kulturore, në fushën e arkeologjisë, objekteve me interes paleontologjik, prehistorik, numizmatik, etnografik, të qytetërimit antik e mesjetar, dorëshkrimeve, kodikëve, mbishkrimeve, qyteteve muze, parqeve, objekteve të kultit etj.

Fenomeni i trafikimit të veprave të artit e kulturës, nuk është problem vetëm i Shqipërisë, por një problem ndërkombëtar me përmasa për të gjithë botën. Në trafikun ndërkombëtar të veprave të artit ekzistojnë njëkohësisht vendet e origjinës, vendet ku këto objekte kalojnë tranzit dhe vendet destinacion tregu. Vendi ynë kryesisht nuk evidentohet si një vend destinacion për veprat e artit, por më tepër një vend origjine, me destinacion tregun e jashtëm.

Numri i objekteve të trashëgimisë sonë kulturore, të trafikuar jashtë shtetit, është relativisht i madh, referuar faktit të vjedhjes së tyre masive në të kaluarën, apo kërkesës së tregut të jashtëm për këto objekte.

Gjithashtu është i njohur fakti i gërmimeve të paligjshme nëpër qendrat arkeologjike historike, apo i kërkimeve nënujore, të kryera nga shtetas shqiptarë apo të huaj, të cilët kanë për qëllim, gjetjen përvetësimit dhe trafikimit të veprave të artit jashtë shtetit. Ndërkohë ka të dhëna për ndërtime të reja, me ose pa leje nga organet kompetente mbi objekte apo banesa monument kulture, apo me vlera për trashëgiminë kulturore.

Gjithashtu janë të shumta dhe rastet e vjedhjes së ikonave (ikonostaseve) nëpër kisha, kryesisht në rajonin juglindor dhe jugperëndimor të Shqipërisë, me qëllim trafikimit të tyre jashtë vendit.

Ruajtja e objekteve apo e vendeve ku ruhen vlera të trashëgimisë kulturore, është një problem më vete që lë hapësira për abuzime nga elemente me prirje kriminale në drejtim të kërkimeve të paligjshme, përvetësimit, vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit dhe kulturës.

Për policinë shqiptare, lufta kundër vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës, përbën një ndër angazhimet e saj, në kuadrin e përgjithshëm të luftës kundër krimit të organizuar.

Policia e Shtetit i ka mundësitë dhe bazën ligjore që të përdorë metoda dhe mjete speciale të hetimit, për goditjen e aktivitetit kriminal, në fushën e vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës. Në Kodin e Procedurës Penale janë shtuar dispozita për “teknikat e posaçme të hetimit”, si blerja e simuluar dhe agjentët e infiltruar, metoda këto që në bazë të ligjit procedural penal, mund të aplikohen në hetimet që kanë lidhje me vjedhjen dhe trafikimin e veprave të artit e kulturës.

Nga hetimi i rasteve dhe informacionet e grumbulluara, rezulton se veprat e artit të vjedhura apo të përvetësuar në rrugë të paligjshme në Shqipëri, trafikohen jashtë vendit si nëpërmjet pikave të kalimit kufitar apo edhe jashtë tyre.

Kalimi nëpërmjet vendkalimeve kufitare është i mundshëm, kryesisht për shkak të mungesës së eksperiencës dhe njohurive të pamjaftueshme në fushën e veprave të artit e kulturës, të autoriteteve përgjegjëse në pikat e kalimit kufitar (si dogana apo policia kufitare), kamuflimit të tyre në mjete të rënda me mallra apo anije transporti, falsifikimit të dokumentacionit shoqëruar, përmasave të vogla të objekteve që trafikohen etj.

Legjislacioni shqiptar

Vjedhja dhe trafikimi i veprave të artit e kulturës, është e parashikuar si veprë penale në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë, në dy dispozita të veçanta dhe konkretisht.

- Vjedhja e veprave të artit e kulturës, parashikuar nga neni 138 i Kodit Penal, ku thuhet:

“Vjedhja e veprave të artit e kulturës, dënohet me gjobë ose burgim gjer në pesë vjet.

Vjedhja e veprave të artit e kulturës me rëndësi kombëtare, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.”

- Trafikimi i veprave të artit e kulturës, parashikuar nga neni 138/a i Kodit Penal (shtuar në Kodin Penal me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 39), ku thuhet:

“Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin i veprave të artit e kulturës, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”

- Ligji nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, ku janë të përcaktuar objektet e trashëgimisë kulturore, kategorizimi i tyre, rregullat e ruajtjes, rregullat për transaksionet dhe shitblerjen e tyre, si dhe sanksionet e parashikuara në rastet e shkeljes së parashikimeve në këtë ligj.

- Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

Krime të tjera që lidhen me trafikimin e veprave të artit janë “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, “Kontrabanda”, “Mashtrimi” etj.

Legjislacioni ndërkombëtar

Konventa e UNESCO-s, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Konventa për Mjetet e Ndalimit dhe të Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8523, datë 9.9.1999.

Bashkëpunimi

Hetimi i rasteve të vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës kërkon një nivel të caktuar të njohurive në fushën e veprave të artit e kulturës, e për rrjedhojë kërkohet një bashkëpunim i agjencive të zbatimit të ligjit në fushën e hetimit të veprave penale, policisë dhe prokurorisë (trajtime nga specialistë të artit e kulturës, arkeologjisë).

Informacionet paraprake që merren për vjedhjen dhe trafikimin e veprave të artit, apo bllokimin e tyre nga autoritete policore homologe, për vetë natyrën specifike të kësaj vepre penale, kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet strukturave të hetimit dhe agjencive të specializuara në fushën e artit dhe kulturës, si dhe me Zyrën Qendrore Kombëtare të Interpolit e Organin e Prokurorisë.

Kështu, në raste të bllokimit të veprave të artit e kulturës me origjinë nga Shqipëria, nga autoritete homologe kërkohen detaje që vërtetojnë origjinën e kësaj vepre, si përmasat e objektit, lloji i materialit, vendgjetja e tij, vendi i ruajtjes, numri i inventarit, fotografi, e detaje të tjera, që vërtetojnë origjinën e pronësinë e një vepre (pasaporta e objektit).

Vendi ynë vitet e fundit ka bërë një progres të dukshëm, duke aderuar në instrumente europiane dhe ndërkombëtare, të cilat e lehtësojnë bashkëpunimin në fushën penale, sikurse edhe duke nënshkruar një numër të madh marrëveshjesh dypalëshe.

Problematika e evidentuar

- Institucionet kombëtare të cilat kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës janë: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, institucionet fetare, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Shërbimi Informativ Shtetëror, njësitet e qeverisjes vendore, arkivat etj. Midis këtyre institucioneve dhe Policisë së Shtetit ekziston një bashkëpunim në drejtim të shkëmbimit të informacionit, por kërkohet një bashkërendim më i mirë i aktiviteteve.

- Mungesa e një inventari të saktë me të dhëna të detajuara (me fotografi apo të dhëna të tjera identifikuese) për veprat e artit e kulturës, të vjedhura e përveçësuar në vite në muzetë apo institucionet e tjera kulturore fetare në Shqipëri, gjatë vitit 1997 e më pas.

- Mungesa e strukturave të specializuara policore në luftë kundër këtij fenomeni (kemi parasysh këtu se në disa vende ka struktura të posaçme të policisë, të specializuara për hetimin e veprave penale që lidhen me artin e kulturën).

- Numri i madh i institucioneve të përfshira në administrimin dhe ruajtjen e këtyre pasurive, dhe fondet e pamjaftueshme për ruajtjen e administrimin e tyre.



- Mungesa e bashkëpunimit rajonal ndërmjet strukturave përgjegjëse në luftë kundër fenomenit të kërkimit të paligjshëm, përvetësimit, vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës.

- Njohuri dhe investim i pamjaftueshëm i specialistëve të policisë, kontrollit kufitar dhe doganave, për veprat e artit dhe kulturës, si dhe format e metodat e përdorura nga individë apo grupe kriminale të përfshira në vjedhjen dhe trafikimin e veprave të artit e kulturës.

- Ekzistenca e një tregu informal në tregtinë e veprave të artit brenda vendit, pasi kemi të bëjmë me një aktivitet tregtar (pikturat që shiten nga autorë të ndryshëm, shitja e objekteve të ndryshme në pazarin e Krujës etj.)

- Mungesa në ndërgjegjësimin e publikut, e programeve të edukimit për pasojat e ekzistencës së tregut të veprave të artit, nxjerrjes së tyre jashtë kufijve.

- Mungesa e një liste të ekspertëve me njohuri specifike në fushën e veprave të artit e kulturës, në dispozicion të autoriteteve policore dhe prokurorisë, për dhënien e vlerësimeve në rastet e sekuestrimit të objekteve të dyshuara si vepra arti.

Plani i veprimit përmban këto elemente:

- Objektivat

- Llojet e veprimtarive që do të kryhen.

- Institucionet përgjegjëse.

- Burimet financiare dhe partnerët e mundshëm në zbatimin e detyrës.

- Treguesit e arritjeve të pritshme.

OBJEKTIVAT

Objektivat kryesorë janë:

1. Parandalimi i vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës, si dhe kërkimeve arkeologjike të paautorizuara.

2. Trajnimi dhe krijimi i kapaciteteve, të reja në kundërvënien të vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës.

3. Identifikimi i trafikantëve të veprave të artit, inicimi i hetimeve profesionale, dhe vënia e tyre përpara drejtësisë.

Objektiva specifike:

- Drejtimi dhe bashkërendimi i veprimtarive të institucioneve kombëtare përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të veprave të artit e kulturës.

Aktivitetet	Institucionet Përgjegjës	Afati kohor	Tregues	Burimet
<p>1.1 Përgatitja e një materiali përmbledhës në bazë qarku, në lidhje me fondet e trashëgimisë kulturore në qarkun përkatës, për sa i përket parqeve arkeologjike, muzeve historikë e arkeologjikë, arkivave të shtetit në rrethe, objekteve të kultit, monumenteve të kulturës, në tërësi gjendjes së objekteve, si edhe vendeve që ruajnë e ekspozojnë trashëgimi kulturore. Një kopje e këtij materiali t'i dërgohet dhe QKIPK-së.</p>	<p>Dr.Pol.Qarkut dhe Institucionet që i administrojnë këto fonde.</p>	<p>2012-2013</p>	<p>1.1 Njohja e situatës, në rajonin përkatës në drejtim të pasurive kulturore, vendeve e mënyrën e ruajtjes, si dhe gjendjes së riskut, për objektet e trashëgimisë kulturore.</p>	<p>Ekzistues</p>
<p>1.2 Krijimi i një inventari të plotë kombëtar të regjistruar pranë QKIPK-së, të objekteve të trashëgimisë kulturore. Përfundimin e inventarit të objekteve të trashëgimisë kulturore të humbura deri tani, inventarin e objekteve ekzistuese, si dhe depozitimim e lidhjen e tyre me <i>database</i>-in e QKIPK-së (Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore), me pikat e kalimit të kontrollit të kufirit në rrugë tokësore, ajrore e detare.</p>	<p>MTKRS, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Antropologjisë QKIPK-ja</p>	<p>2012-2013</p>	<p>1.2 Kjo do të mundësonte një informacion të shpejtë dhe të saktë në mënyrë që administrata shtetërore të ketë në çdo kohë informacion për një menaxhim bashkëkohor, si dhe të kontrollohet me lehtësi lëvizja e objekteve, brenda e jashtë territorit të vendit. Kartela e unifikuar dhe baza kombëtare e të dhënave përbëjnë një sukses, ligjor dhe praktik, pasi ato do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në luftën antitrafik. Lehtësimi i procedurave për kërkimin, gjetjen dhe rikthimin e objekteve të vjedhura e trafikuar jashtë shtetit.</p>	
<p>1.3 Institucionet shtetërore që administrojnë objektet e trashëgimisë kulturore në të gjithë vendin duhet të depozitojnë pranë QKIPK-së dosjet e plota të objekteve të trashëgimisë kulturore që posedon rrjeti muzeal dhe fondet e këtyre institucioneve me qëllim krijimin e një inventari kombëtar të plotë dhe të saktë të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe katalogimin</p>		<p>2012</p>	<p>1.3 Monitorimi i situatës kundër kërkimeve të paligjshme arkeologjike, vjedhjes, tregtimit të paligjshëm dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës.</p>	



informatik të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar, si dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore.				
2. Krijimi i grupit ndërinstytucional të punës, për monitorimin e luftës kundër vjedhjes e trafikimit të veprave të artit e kulturës, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të çdo institucioni përgjegjës (DPPSH, MTKRS, DPD etj.)		2012		
2.1 Hartimi i projekteve për rregullime ligjore për sa i përket individëve që veprojnë në tregun e veprave të artit (si p.sh. koleksionistë të ndryshëm, numizmatë, filatelistë, antikuaristë, që shesin sende të vjetra me vlerë). Në mënyrë të veçantë në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe ato tatimore e financiare të realizohet koordinimi i nevojshëm për të rregulluar shitblerjen e këtyre objekteve veçanërisht në tregun e pazarit të Krujës, Gjirokastrës, Beratit, Korçës ku përveç riprodhimeve të këtyre objekteve me vlerë që shiten si suvenirë shpesh përfundojnë edhe objekte origjinale që disponohen nga individë, të cilët në mungesë të ndërgjegjësimit e vështirësive financiare i shesin kundrejt vlerave të papërfillshme.	MTKRS	2012	2.1 Krijimi i një baze më efikase ligjore, për një bashkëpunim më të mirë ndërinstytucional, me qëllim parandalimin dhe goditjen e fenomeneve që ndikojnë në cenimin e pasurive të trashëgimisë kulturore.	Ekzistues
2.2 Përbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet QKIPK-së dhe DPD-së në respektimin e mbrojtjes së pasurive kulturore të popullit shqiptar, si aspekt i rëndësishëm i identitetit kombëtar. QKIPK është institucioni i ngarkuar me ligj për inventarizimin, kartelizimin, katalogimin informatik dhe nxjerrjen e pasaportës së objekteve të trashëgimisë kulturore. Ai ka të drejtën e përgatitjes së dokumentacionit për lëvizjen e objekteve, pavarësisht nga pronësia mbi to, brenda e jashtë vendit. DPD-ja ka përgjegjësinë ligjore për garantimin e kontrollit të lëvizjes së autorizuar të objekteve të trashëgimisë kulturore.	MTKRS QKIPK DPD	Në vijim 2012	2.2 Rritja e efikasitetit të strukturave të specializuara në drejtim të parandalimit të trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.	
2.3 Krijimi i pikave të kontaktit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së	DPPSH DTK		2.3 Shkëmbimi i shpejtë i	

<p>Shtetit, Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore, QKIPK-së dhe Institutit të Arkeologjisë.</p>	<p>QKIP IA</p>		<p>informacionit, në rast situatash të ngutshme për problematikën e vjedhjes dhe veprave të artit e kulturës dhe ekspertimi e vlerësimi pa vonesë i tyre.</p>	
<p>3. Formimi i një grupi të ekspertëve me njohuri specifike në fushën e veprave të artit e kulturës sipas llojit (arkeologji, etnografi, pikturë, skulpturë, numizmatikë etj.), me qëllim kryerjen e ekspertimeve përkatëse, si dhe trajnimin e personelit me njohuri në këtë fushë.</p> <p>3.1 Ndërmarrja e një fushate informimi për institucionet që merren me ruajtjen dhe administrimin e veprave të trashëgimisë, veçanërisht lidhur me hapat që duhen ndjekur kur ato konstatojnë vjedhjen apo dëmtimin e një vlere të tillë nga objektet që kanë në ruajtje, e cila duhet të shoqërohet edhe me elementë vizivë (p.sh. fletëpalosje, udhëzues etj.) dhe lipset t'u tregojë atyre procedurën e hapat e duhur ligjorë që duhet të ndërmarrin dhe rolin e detyrën e secilit institucion në të (p.sh. që nga Drejtoria Rajonale e Policisë, Zyra e Interpolit, nevoja për kryerjen e ekspertimeve etj.).</p> <p>3.2 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinsticionale, me qëllim aksesin në databazën e QKIPK-së, për shkëmbimin e shpejtë dhe të saktë të informacionit për çdo objekt të trashëgimisë kulturore.</p>	<p>QSA DTK QKIPK</p> <p>DTK QKIPK DPPSH DPD</p> <p>DPPSH DPD QKIPK</p>	<p>2012</p> <p>Në vijim</p> <p>2012</p>	<p>3. Qëllimi është pasja e një liste të ekspertëve përkatës me njohuri të posaçme për gjini të ndryshme në drejtim të njohjes e vlerësimit të veprave të artit e kulturës, si në rastin e hetimeve, gjetjen e objekteve të ndryshme dhe trajnimin e personelit.</p> <p>3.1 Ndërgjegjësimi i autoriteteve dhe komunitetit në përgjithësi për vlerat e trashëgimisë kulturore, dhe njohja e detyrimeve dhe procedurave për autoritetet përgjegjëse.</p> <p>3.2 Krijimi i lehtësirave të nevojshme për një kontroll më efikas në pikat e kontrollit kufitar doganor, për parandalimin e trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.</p>	



<p>3.3 Bashkëpunimi me Komitetin Shqiptar të Kulteve, me qëllim evidentimin dhe regjistrimin e pasurive të trashëgimisë kulturore në fushën e kulteve fetare. Identifikimi dhe katalogimi i objekteve në pronësi të institucioneve fetare, të pidentifikuara më parë e si rrjedhojë të pakataloguara.</p>	<p>KSHK DTK QKIPK</p>	<p>2012 -2013</p>	<p>3.3 Krijimi i një baze të dhënash ku të regjistrohen, me të dhëna të plota e foto, pasuritë e trashëgimisë kulturore në posedim të enteve të kultit (sipas formatit të objekteve të inventarizuara nga QKIPK-ja). Lehtësimi i procedurave të kërkimit, gjetjes dhe rikthimit në rast të vjedhjes e trafikimit të këtyre objekteve.</p>	<p>Ekzistues</p>
<p>Fuqizimi i kontrollit kufitar 4. Të forcohet kontrolli në hyrje-dalje të pikave të kontrollit kufitar të vendit tonë nëpërmjet zbatimit të rregullave strikte të kontrollit dhe gjetjes së formave e metodave më efikase për identifikimin e trafikantëve të veprave të artit e kulturës.</p> <p>4.1 Shfrytëzimi i faqes ASF 2, të Interpolit, si dhe atë të QKIPK-së, për vepra arti të vjedhura e shpallura në kërkim ndërkombëtar, si dhe ato që tentojnë t'i kalojnë në mënyrë të paligjshme jashtë shtetit, nëpërmjet kufirit shtetëror.</p>	<p>DPPSH (Dep. për Kuf. dhe Migr.) DPD</p>	<p>Në vijim</p>	<p>4. Parandalimi i trafikimit të veprave të artit të vjedhura apo të gjetura nga gërmime të paligjshme.</p> <p>4.1 Identifikimi i veprave të artit të vjedhura në tentativë trafikimi, nëpërmjet kontrollit selektiv të bagazheve të personave të dyshuar. Kapja në flagrancë e trafikantëve të veprave të artit të vjedhura dhe bashkëpunëtorëve të tyre.</p>	<p>Ekzistues</p>
<p>4.2 Njësimi i katalogut të humbjeve në databazën e QKIPK-së me faqen ASF 2 të Interpolit me qëllim që të kemi një informacion të saktë dhe në kohë në nivel ndërkombëtar. Të mundësohet plotësimi i të dhënave të objekteve të humbura sipas formatit të Interpolit (Object ID). T'i kërkohet zyrës së Interpol - Tirana mundësimi i këtij formati.</p>	<p>QKIPK Interpol-Tirana</p>	<p>2012</p>	<p>4.2 Lehtësimi i procedurave të kërkimit, gjetjes dhe rikthimit të objekteve të vjedhura apo të trafikuar.</p>	

<p>4.3 Zbatimi i sanksioneve administrative të parashikuara në ligjin e trashëgimisë kulturore, në çdo rast të konstatimit të shkeljeve të dispozitave të parashikuara në këtë ligj.</p>	<p>DTK</p>	<p>Në vijim</p>	<p>4.3 Ndëshkimi administrativ i personave të cilët kapen në shkelje të dispozitave ligjore të parashikuara nga ligji i trashëgimisë kulturore.</p>	
<p>5. Zbatimi i praktikave më të mira, për grumbullimin e të dhënave prej burimeve të kualifikuara të informacionit, për persona apo grupe personash të përfshirë në aktivitetin e paligjshëm, të vjedhjes, trafikimit të veprave të artit, si dhe kërkimeve të paligjshme arkeologjike apo nënujore.</p> <p>5.1 Inicimi i hetimeve proaktive, në bashkëpunim me SHISH dhe Prokurorinë.</p> <p>5.2 Hetimi me profesionalizëm dhe përgjegjësi, për çdo rast të denoncimit për vjedhje, trafikim apo shkatërrim të objekteve të trashëgimisë kulturore.</p> <p>5.3 Publikimi i operacioneve të suksesshme kundër vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit dhe kulturës.</p>	<p>DPPSH, Drejtoritë Rajonale të Policisë</p>	<p>Në vijim</p>	<p>5. Evidentimi i personave të cilët dyshohet se merren me aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të veprave të artit dhe kulturës.</p> <p>5.1 Kryerja e hetimeve të suksesshme, përvetësimi dhe aplikimi i praktikave më të mira.</p> <p>5.2 Parandalimi i vjedhjes, trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe penalizimi i personave të përfshirë.</p> <p>5.3. Ndërgjegjësimi i opinionit për pasojat penale në rast të implikimit në veprimtari të paligjshme në dëm të trashëgimisë kulturore.</p>	<p>Ekzistues</p>
<p>6. Njohja nga strukturat e Policisë dhe doganave të modelit të dokumentacionit shoqëruar me të cilën një vepër arti e blerë, e dhuruar apo për qëllime ekspozimi lëviz jashtë territorit të Shqipërisë. Afishimi i këtij model-dokumenti në pikat e kalimit kufitar dhe doganor. Pasaporta e objektit të lëshuar nga QKIPK-së përcakton dhe statusin e objektit si trashëgimi kulturore ose jo. Në pikat e kalimit të kufirit e vetmja leje ligjore për objektet e trashëgimisë kulturore është ajo e lëshuar</p>	<p>DPPSH DPD QKIPK</p>	<p>2012</p>	<p>6. Minimizimi i mundësive të kalimit të kundraligjshëm të veprave të artit nëpërmjet pikave të kalimit kufitar.</p>	<p>Ekzistues</p>



nga MTKRS dhe QKIK DPD, në përputhje me nenin 82, pika 4 të Kodit Doganor, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar (nenet 4, 7, pika 2, 11, 19 e 21), ka detyrimin të ndalojë daljen jashtë shtetit të të gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore pa dokumentacion të rregullt ligjor (pasaportën e objektit të lëshuar nga QKIPK, lejen e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ose të Këshillit të Ministrave).	DPD	Në vijim		
7. Bashkëpunimi me Zyrën Qendrore Kombëtare Interpol-Tirana, për rastet e shpalljes, anulimit, dhe komunikimin me zyrat analoge, për kërkimin, gjetjen dhe kthimin në origjinë të veprave të artit e kulturës të vjedhura në Shqipëri, dhe të bllokuara jashtë shtetit.	DPPSH	Në vijim	7. Lehtësimi i procedurave të kërkimit, gjetjes dhe riatdhesimit të veprave të artit të vjedhura në vendin tonë dhe të trafikuar jashtë vendit.	Ekzistues
8. Identifikimi dhe katalogimi i objekteve në pronësi private të paidentifikuara më parë dhe si rrjedhojë të pakataloguara. Zbatimi i ligjit “Për trashëgiminë kulturore” bëhet i detyrueshëm për të gjithë objektet që dalin jashtë shtetit, qoftë për një afat të përcaktuar, qoftë përgjithmonë, pra për shitje, dhurim a ndryshim vendbanimi, duhet të regjistrohen në bazën e të dhënave, për të marrë lejen përkatëse. Kur janë pronë private objektet kontrollohen nga Komisioni Shtetëror i Vlerësimit, i cili i sugjeron Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve veprimtarinë e mëtejshme, pra lejimin apo moslejimin e lëvizjes, konform ligjit.	QKIPK DTK KSHK	2012 e vazhdim	8. Regjistrimi i objekteve që përbëjnë pasuri ose trashëgimi kulturore dhe certifikimi i tyre.	Ekzistues
9. Strukturat vendore të policisë të mbajnë kontakte të vazhdueshme dhe të shkëmbejnë të dhëna me institucionet që ruajnë, administrojnë dhe ekspozojnë objekte me vlera për trashëgiminë kulturore (drejtoritë rajonale të muzeve, parqeve arkeologjike etj.), për sa i përket sigurisë së këtyre objekteve, ekspeditave kërkimore, apo dhe kërkimeve të paligjshme arkeologjike nga persona të paautorizuar që synojnë përvetësimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.	Drejtoritë e Policisë në qarqe, drejtoritë rajonale të muzeve	2012	9. Marrja në kohë e të dhënave për veprimtari të paligjshme, në fushën e kërkimeve të paligjshme arkeologjike, përvetësimit të objekteve me vlerë për trashëgiminë, dhe parandalimin e vjedhjes dhe trafikimit të tyre, si	Ekzistues

			dhe penalizimin e personave të përfshirë.	
<p>Trajnimi dhe forcimi i kapaciteteve Të zhvillohen programe trajnimi me specialistët e policisë dhe doganave që janë përgjegjës për parandalimin e vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit, për shtimin e njohurive profesionale</p> <p>10. Krijimi i një bërthamë specifike policore në qendër e bazë, pranë Sektorit Kundër Krimit të Organizuar (pjesë e strukturave kundër trafikeve të paligjshme), e cila të trajnohet në vazhdimësi për një punë më të specializuar kundër vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës.</p> <p>10.1 Zhvillimi i trajnimeve me punonjësit e policisë, doganave, për shtimin e njohurive profesionale që lidhen me trashëgiminë kulturore në tërësi, legjislacionin për veprat e artit e kulturës. Konkretisht, shihet si më emergjente që nga specialistë pranë Drejtorisë së Trashëgimisë Kombëtare, Institutit të Arkeologjisë, QKIPK-së, Institutit të Studimit të Arteve, duhet të ofrohen kurse trajnimi për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe doganave, si në qendër ashtu edhe në rajone të ndryshme në Shqipëri, kryesisht nëpër zonat ku janë më tepër të përqendruara vlerat e trashëgimisë kulturore.</p> <p>10.2 Trajnimi i oficerëve të policisë (specialistëve të luftës kundër trafikeve të paligjshme), në drejtim të njohjes së legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e veprave të artit e kulturës (ligji i trashëgimisë kulturore, Konventa e UNESCO-s etj.), formave të trafikimit të veprave të artit dhe mjetet e metodat më efikase hetimore në luftë kundër këtij fenomeni. Përvetësimi i praktikave më të mira (nga hetimet, trajnimet, brenda dhe jashtë vendit) në funksion të një pune më të mirë kundër fenomenit të vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit dhe kulturës.</p>	<p>DPPSH</p> <p>DTK IA QKIPK Institucionet artistike</p> <p>QSA (Institutit i Arkeologjisë dhe i Studimit të Arteve), MTKRS DPPSH DPD</p>	2012	<p>10. Rritja e treguesve të punës policore, në drejtim të evidentimit të problematikës dhe marrjen e masave për parandalimin dhe goditjen e aktivitetit kriminal në fushën e vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës (nëpërmjet një strukture solide policore të specializuar).</p> <p>10.1 Njohja e veprave të artit në tërësi, pasurive dhe trashëgimisë kulturore të vendit, objekteve me të riskuara apo që synohen nga trafikantët.</p>	
		2012	<p>10.2 Njohja e legjislacionit, kombëtar dhe ndërkombëtar për veprat e artit e kulturës, format dhe metodat efikase hetimore në këtë drejtim.</p>	
11. Të rritet ndërgjegjësimi ndërmjet punonjësve të institucioneve kombëtare	DPPSH DTK	Në vijim	11. Rritja e efikasitetit të punës	Ekzistues



përgjegjëse (policisë, doganave, DTK-së, arkivave, njësi të qeverisjes vendore) për bashkëpunimin ndërmjet tyre për rritjen e efektshmërisë së punës, në drejtim të parandalimit të vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit dhe hetimeve profesionale të rasteve të evidentuara për këtë fenomen.	DPD		së institucioneve kombëtare përgjegjëse për parandalimin dhe goditjen e këtij aktiviteti kriminal.	
12. Të rritet ndërgjegjësimi i opinionit publik për dëmet dhe efektet negative për kulturën dhe shoqërinë shqiptare, që sjell fenomeni i vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës. Publikimi i rasteve të penalizimeve apo arrestimeve të kryera nga policia në lidhje me vjedhjen dhe trafikimin e veprave të artit e kulturës.	DTK DPPSH QKIPK	Në vijim	12. Botime të ndryshme për efektet negative për kulturën, ekonominë dhe shoqërinë shqiptare, që sjell fenomeni i vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës, me pjesëmarrës nga institucionet kombëtare përgjegjëse.	Ekzistues

LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA

QSA	Qendra e Studimeve Albanologjike
IA	Instituti i Arkeologjisë
DTK	Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
KSHK	Komiteti Shqiptar i Kulteve
QKIPK	Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore

VENDIM

Nr.922, datë 21.12.2011

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 21 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, më poshtë e quajtur DPPPP, si institucion qendror buxhetor, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Financave.

2. DPPP-jë është njësi e inteligjencës financiare shqiptare dhe funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe autoritetet e tjera kompetente të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. DPPP-jë përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

4. DPPP-jë bashkëpunon me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet përkatëse, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të zbatimit të standardeve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për harmonizimin e legjislacionit me këto standarde.

5. Drejtori i Përgjithshëm, në zbatim të detyrave të ngarkuara me ligj, ushtron këto përgjegjësi:

a) Drejton DPPP-në dhe e përfaqëson atë brenda dhe jashtë vendit.

b) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me njësi homologe të inteligjencës financiare në zbatim të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

c) Organizon punën për hartimin e raportit vjetor, brenda afatit ligjor, si dhe vendos publikimin e tij në gjuhën shqipe dhe angleze.

ç) U raporton me shkrim Ministrit të Financave dhe Kryeministrit, sa herë që i kërkohet, por jo më pak se 2 (dy) herë në vit, për veprimtarinë e DPPP-së dhe problematikat që kanë të bëjnë me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

d) Raporton sa herë që kërkohet në komisionet parlamentare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë e DPPP-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

dh) Drejton dhe orienton punën e grupit teknik ndërinstitucional në kuadrin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave.

e) Me miratimin e Ministrit të Financave, emëron zëvendës drejtorët e përgjithshëm, të cilët janë edhe drejtorë të drejtorive përkatëse.

ë) Emëron, shkarkon dhe liron nga shërbimi në DPPP punonjësit e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

f) Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, nxjerr urdhra, udhëzime e detyra në nivel drejtorie apo për strukturat brenda saj, si dhe organizon ushtrimin e kontrollit për zbatimin e tyre.

g) Merr vendime administrative për rastet e shkeljeve të konstatuara nga Drejtoria e Inspektimit dhe Legjislacionit.

6. DPPP-jë është institucion qendror buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit. Të ardhurat e siguruar nga vjelja e gjobave derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

7. Vendimi nr.108, datë 11.2.2005 i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”, të ndryshuar, shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.923, datë 21.12.2011

**PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN E DETYRAT E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE
REGJISTRIMIT TË PLEHRAVE PËR PËRDORIM PËR BIMËSINË, SI DHE PROCEDURAT E
HOLLËSISHME PËR REGJISTRIMIN E VLERËSIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Përbërja dhe funksionimi i Komisionit të Vlerësimit dhe Regjistrimit të Plehrave për përdorim për bimësinë

1. Komisioni i Vlerësimit dhe Regjistrimit të Plehrave për përdorim për bimësinë, për plehrat që nuk kanë emërtimin “EC fertilizers”, kryesohet nga zëvendësministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe ka në përbërje 8 (tetë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) Dy përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- b) Tre përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- c) Tre përfaqësues nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë.

2. Lista emërore e anëtarëve të komisionit miratohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pas propozimit të bërë nga institucionet përkatëse.

3. Anëtari i komisionit zëvendësohet kur:

a) ai përfaqësues i ministrisë/institucionit, nuk është më në marrëdhënie pune në ministri/institucion;

b) ai është në konflikt interesi me detyrën e tij si anëtar;

c) ai mungon pa arsye në tri mbledhje të komisionit.

4. Mbledhjet e komisionit thirren si rregull një herë në tre muaj nga kryetari, por në raste të veçanta, kur vlerësohet nga kryetari, komisioni mund të mbledhet në çdo kohë

5. Komisioni i zhvillon mbledhjet me pjesëmarrjen e jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

6. Data, ora dhe vendi i ditës së mbledhjes u njoftohen me shkrim anëtarëve, të paktën 10 (dhjetë) ditë para mbledhjes, duke u dërguar atyre edhe materialet përmbledhëse që do të shqyrtohen në mbledhje.

7. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi në fushën e aktivitetit të komisionit dhe duhet të deklarojnë paraprakisht marrëdhëniet, nëse kanë, me subjektet prodhuese të plehrave.

8. Sekretar i komisionit caktohet një prej përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

9. Prodhuesi i dorëzon sekretarit të komisionit kërkesën dhe dokumentacionin për vlerësimin dhe regjistrimin e plehrave në formë shkresore dhe elektronike (CD).

10. Radha e shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin e plehrave bëhet sipas datës së pranimit të tyre.

11. Në përfundim të mbledhjes, hartohet një procesverbal përmbledhës, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Ky procesverbal mbahet në dy kopje, nga të cilat njëra mbahet në dosjen që arkivohet në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe kopja tjetër mbahet në komision. Procesverbali i bashkëlidhet vendimit/vendimeve të marra nga komisioni.

II. Detyrat e Komisionit të Vlerësimit dhe Regjistrimit të Plehrave për përdorim për bimësinë

1. Komisioni gjatë kryerjes së aktivitetit të tij ka këto detyra:

a) Vlerëson plehrat që nuk kanë emërtimin “EC fertilizers”, të cilat prodhohen dhe/ose tregtohen në Republikën e Shqipërisë.

b) Vendos për regjistrimin e plehrave në bazë të kërkesës së prodhuesit të plotësuar sipas formularit të dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe në bazë të përcaktimeve të nenit 15 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.

c) Vendos për afatin e vlefshmërisë së certifikatës së regjistrimit, rast pas rasti, në varësi të tipit të plehut, dhe ia lëshon prodhuesit këtë certifikatë regjistrimi, sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe në përputhje me nenin 16 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.

ç) Vendos për testimin fushor të plehut, kur gjykon për nevojën e verifikimit të vlefshmërisë së tij.

d) Refuzon dhënien e certifikatës së regjistrimit.

dh) Vendos për anulimin e vendimit të regjistrimit, rinovimin e regjistrimit dhe regjistrimin e ri të plehut.

e) Publikon listën e përditësuar të plehrave të miratuar sipas kërkesave të këtij vendimi.

III. Procedurat për vlerësimin dhe regjistrimin e plehrave

1. Për vlerësimin dhe regjistrimin e plehrave, nga komisioni ndiqen procedurat e mëposhtme:

a) Për regjistrimin e një plehu, prodhuesi paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimit në nenin 15 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.

b) Sekretari i komisionit merr në dorëzim kërkesën dhe dokumentacionin për regjistrimin e plehut, i cili duhet të jetë origjinal dhe në formë shkresore e elektronike (CD), si dhe mostrat e plehut, të garantuara nga prodhuesi.

c) Kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e plehut paraqiten në gjuhën shqipe dhe, kur prodhuesi është i huaj, ky dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze.

ç) Prodhuesi, bashkë me kërkesën për regjistrim, duhet të dorëzojë edhe faturën e tarifës për marrjen e certifikatës së regjistrimit dhe regjistrimin e plehrave që nuk kanë emërtimin “EC fertilizers”.

d) Në rastin e vendosjes së testimit fushor të plehrave, komisioni i kërkon Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë, kryerjen e testeve dhe dërgimin e menjëhershëm të rezultateve pranë komisionit.

dh) Kur dokumentacioni i paraqitur për regjistrimin e një plehu është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 15 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, komisioni i jep certifikatën e regjistrimit prodhuesit. Certifikata plotësohet në gjuhën shqipe. Kur prodhuesi është i huaj, si dhe në rastet kur kërkohet, certifikata plotësohet në gjuhën shqipe dhe angleze.

e) Kur dokumentacioni i paraqitur për regjistrim nuk është i plotë, komisioni ia kthen prodhuesit për plotësimin e tyre sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”. Prodhuesi duhet ta dorëzojë dokumentacionin e plotësuar brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e kthimit të tyre për plotësim.

2. Refuzimi i regjistrimit të plehut bëhet kur:

a) prodhuesi nuk plotëson dokumentacionin e kërkuar, brenda afatit të përcaktuar më sipër;

b) komisioni konstaton se në dosjen e regjistrimit janë paraqitur të dhëna false ose të gabuara;

c) inspektorët konstatojnë se prodhuesi që është në proces regjistrimi ka vendosur në treg plehra të paregjistruara nga komisioni;

ç) të dhënat tregojnë se vendosja në treg dhe përdorimi i plehrave përbëjnë një rrezik që vlerësohet i papranueshëm.

3. Anulimi i vendimit të regjistrimit të plehut bëhet kur:

a) prodhuesi e kërkon, me shkrim, një gjë të tillë;

b) prodhuesi shkel njërën nga kërkesat e ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.



4. Kur komisioni vendos për refuzimin e regjistrimit të plehut, për anulimin e vendimit të regjistrimit të plehut dhe për regjistrimin e ri të plehut, duhet të njoftojë me shkrim prodhuesin, duke dhënë shpjegime të hollësishme për arsyet e marrjes së këtij vendimi.

5. Kur mbaron afati i regjistrimit të një plehu, mund të kryhet rinovimi i regjistrimit të tij nëse është bërë kërkesa me shkrim nga prodhuesi, si dhe nëse është dorëzuar dokumentacioni sipas kërkesave për regjistrim, 6 (gjashtë) muaj përpara përfundimit të afatit të regjistrimit.

6. Rinovimi i regjistrimit të plehut u nënshtrohet të njëjtave procedura, që ndiqen për regjistrimin fillestar. Komisioni, kur e gjykon të arsyeshme, mund t'i kërkojë prodhuesit të japë informacion të mëtejshëm, për të vendosur për rinovimin ose jo të regjistrimit.

7. Dokumentacioni origjinal për regjistrimin e plehut mbahet në arkivin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe kopja e tyre mbahet në komision.

8. Certifikata e regjistrimit të plehut mbahet në tri kopje origjinale, nga të cilat njëra mbahet në dosjen që arkivohet në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, njëra në komision dhe kopja e tretë i jepet prodhuesit.

9. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

KËRKESE PËR REGJISTRIMIN E PLEHRAVE

Drejtuar: Komisionit të Vlerësimit dhe Regjistrimit të Plehrave
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Unë i nënshkruari (Emri, atësia, mbiemri) _____
Deklaroj se jam banues në _____

Tel/faks. _____ cel. _____ e-mail _____
Dokumenti i identifikimit _____

- Deklaroj se jam prodhues i plehrave dhe kërkoj të regjistrohem pranë këtij Komisioni, pasi i plotësoj të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.

- Nuk jam në proces falimentimi, në proces hetimi, në proces gjyqësor dhe nuk kam detyrime financiare ndaj të tretëve.

- Deklaroj se njoh dhe zbatoj ligjin nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.

- Deklaroj se jam/nuk jam regjistruar më parë për prodhimin e plehrave.

- Do të prodhoj plehra sipas kërkesave të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.

1. Vendndodhja e biznesit _____
- 2.a) Emri i plehut _____
b) Tipi i plehut _____
3. Përmbajtja e çdo përbërësi të plehut, përmbajtja e elementeve e të substancave toksike në lidhje edhe me format e ushqyesve dhe format e tretshme _____

4. Dendësia e plehut _____

5. Metoda e përdorimit të plehut sipas kulturave bujqësore _____

6. Kushtet e magazinimit _____

7. Përshkrimi i teknikave, lista e materialeve të përdorura për prodhimin e plehut _____

8. Konfirmoj se nuk është një pleh eksploziv, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehurat e përdorimit për bimësinë _____

9. Garantoj dorëzimin e mostrave që përfaqëson tipin e plehut, që kërkoj të regjistrohet, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm _____



10. Deklaroj se kam paguar tarifën sipas kërkesave të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.

Deklaroj se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Data _____

Kërkuesi

(Emri, atësia, mbiemri)

Shënim. Plotësimi i kësaj kërkesë të bëhet në formë elektronike.

ANEKSI 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
KOMISIONI I VLERËSIMIT DHE REGJISTRIMIT TË PLEHRAVE

Nr.....Prot.

Tiranë, _____

CERTIFIKATË REGJISTRIMI

Nr. _____ datë _____

Komisioni i Vlerësimit dhe Regjistrimit të Plehrave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i mbledhur më datë _____

VENDOSI:

T’i japë z/zj _____ certifikatën e regjistrimit të plehrave që nuk kanë emërtimin “EC fertilizers” për vendosje në treg dhe përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 16 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”.

Me kushtet e mëposhtme:

1. Emri i plehut (*emri i plehut: pleh azotik, potasik, pleh i lëngshëm etj.*)

2. Numri i vendimit të regjistrimit _____

3. Vlerat e përbërësve kimikë dhe fizikë të plehut (*përmbajtja e çdo përbërësi të plehut, përmbajtja e elementeve të substancave toksike në lidhje edhe me format ushqyese e format e tretshme sipas etiketës ose dokumentacionit shoqërues nga vendi i origjinës të krahasuara me analizat laboratorike të mostrave, siguruar nga prodhuesi para hedhjes në treg të plehrave*) _____

4. Metoda e përdorimit të plehut sipas kulturave bujqësore _____

5. Afati i vlefshmërisë _____

KRYETARI

VULA

Shënim. Plotësimi i certifikatës bëhet në formë elektronike.

VENDIM

Nr.138, datë 7.12.2011

PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË KESH SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE 2012–2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë KESH sh.a. për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e KESH sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.139, datë 7.12.2011

PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OST SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE 2012–2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 9 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

10211



konstatoi se:

Aplikimi i OST sh.a., për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 9 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e shoqërisë OST sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.140, datë 7.12.2011

**PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “HEC BISTRICA 1&2” SHA PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hec Bistrica 1&2” sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të “Hec Bistrica 1&2” sh.a., për vitin 2012,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Bistrica 1&2” sh.a., për planin e investimeve për vitin 2012, në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e “Hec Bistrica 1&2” sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2012.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Hec Bistrica 1&2” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.141, datë 7.12.2011

**PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SHA PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin planit të investimeve të “Hec Lanabregas” sh.a., për vitin 2012,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., për planin e investimeve për vitin 2012 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e “Hec Lanabregas” sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2012.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Hec Lanabregas” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.142, datë 7.12.2011

**PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “HEC ULËZ – SHKOPET” SHA PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin planit të investimeve të “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., për vitin 2012,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., për planin e investimeve për vitin 2012 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve



VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2012.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Hec Ulëz – Shkopet” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.143, datë 7.12.2011

PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të “CEZ shpërndarje” sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014,

konstatoi se:

Aplikimi i “CEZ shpërndarje” sh.a., për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, në kushtet kur është përcaktuar detyrimi i uljes së nivelit të humbjeve teknike e joteknike gjatë periudhës së tretë rregullatore dhe është miratuar studimi përkatës i cili shprehet mbi shpërndarjen e nevojave për investime në arritjen e targeteve të vendosura, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë, me kushtin e pikës 2 më poshtë, vlerat e investimeve të parashikuara në aplikimin e bërë nga “CEZ shpërndarje” sh.a., për çdo vit dhe të ndara sipas grupimeve sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Plani i investimeve miratohet me kushtin që investimet e zërave “Nënstacione dhe matje” të rishikohen dhe plotësohen nga “CEZ shpërndarje” sh.a. deri në 31 mars 2012 në frymën e observacioneve të bëra prezent nga ERE për dhënie prioritet investimeve me efektin më të shpejtë dhe me të lartë në zvogëlimin e humbjeve teknike e joteknike (linjat ABC etj.). Plani i rishikuar i investimeve do të shqyrtohet dhe miratohet nga ERE deri më 15 maj 2012.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

PLANI I INVESTIMEVE TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR PERIU DHËN 2012-2014

	Plani i investimeve 2012	Plani i investimeve 2013	Plani i investimeve 2014
Totali	6,500,473,553	6,692,500,000	7,003,410,000
Përshkrimi	Plani i investimeve 2012	Plani i investimeve 2013	Plani i investimeve 2014
1. Pajisje 110 kV	1,194,696,000	950,000,000	1,240,000,000
1.1 Nënstacione	988,440,000	950,000,000	1,240,000,000
1.5 Project preparation 110 kV	20,000,000		
2.3 Transformatorë fuqie TL/TM	186,256,000		
2. Pajisje 6 kV-35 kV	1,937,251,020	1,560,000,000	1,767,410,000
2.1 Linja 6 kV-35kV	1,766,549,008	1,560,000,000	1,767,410,000
2.3 Transformator TM/TM	24,430,000		
2.4 Matësa TM	17,220,000		
2.5 Lidhje të reja TM	50,000,000		
2.9 Kabina transformacioni TM/TU	79,052,012		
3. Pajisje të tensionit të ulët	3,022,066,133	3,973,000,000	3,770,000,000
3.1 Linja TU	1,377,038,038	2,453,000,000	2,310,000,000
3.3 Transformatorë fuqie TM/TU	100,000,000	100,000,000	100,000,000
3.4 Matësa TU	1,545,028,095	1,420,000,000	1,360,000,000
4. Investime të tjera mbështetëse	346,460,400	209,500,000	226,000,000
4.1 Sistemi SCADA			35,000,000
4.2 Prona, ndërtesa, orendi	172,940,000	50,000,000	102,000,000
4.3 Studime dhe konsulenca	15,620,400	15,000,000	15,000,000
4.4 <i>Hardware&Software</i>	115,500,000	80,500,000	
4.5 Teknologji WAN	42,400,000	64,000,000	74,000,000
Totali	6,500,473,553	6,692,500,000	7,003,410,000

VENDIM
Nr.144, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH
SHA PËR PERIU DHËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a., për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012 - 2014), do të jetë 1.00 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

10215



VENDIM
Nr.145, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK
ME SHUMICË PËR PERIUHDHËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a., për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa e energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012–2014) do të jetë 2.83 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.146, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
OST SHA PËR PERIUHDHËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a., për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012–2014), do të jetë 0.65 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.147, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e “CEZ shpërndarje” sh.a., për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012–2014), do të jetë 5 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.
Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.148, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUdhËN E TRETË
RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.80, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e “CEZ shpërndarje” sh.a., për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012–2014) sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.



Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

**TARIFAT E SHËRBIMEVE DHE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014**

Niveli i tensionit	Kategoritë e konsumatorëve	Viti 2012-2014	
		Çmimi lekë/kWh	Çmimi i energjisë në pik (lekë/kWh)
Tensioni i mesëm	Klientë të furnizuar në 35 kV		
	Industri	8.50	9.78
	Tregti dhe shërbime	8.50	9.78
	Bujqësi	8.50	9.78
	Të tjerë	8.50	9.78
	Klientë të furnizuar në 20/10/6 kV		
	Industri	9.10	10.47
	Tregti dhe shërbime	10.00	11.50
	Furrë buke, prodhim mielli	7.10	8.17
	Bujqësi	8.70	10.01
	Të tjerë	9.70	11.16
	Buxhetorë	11.50	13.23
	Tensioni i ulët	Klientë të furnizuar në TU	
Industri		10.50	12.08
Tregti dhe shërbime		12.20	14.03
Furrë buke, prodhim mielli		7.60	8.74
Bujqësi		10.50	12.08
Të tjerë		12.00	13.80
Buxhetorë		14.00	16.10
Familjarë			
Blloku i parë deri në 300 kWh		7.70	
Blloku i dytë mbi 300 kWh		13.50	
Tarifa fikse e shërbimit për leximin "zero" (lekë/muaj)		200	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (shkallë, pompë, ashensor etj. (lekë/kWh)	8.00		
*Çmimi i energjisë reaktive do të jetë 15% e çmimit të energjisë aktive			

Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është
- Për periudhën 1 nëntor-31 mars nga ora 18:00 deri 22:00;
- Për periudhën 1 prill-31 tetor nga ora 19:00 deri 23:00.

VENDIM
Nr.149, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR TË
LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET E
REJA ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 15 MW
PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.87, datë 16.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007”, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, neneve 15, 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.24, datë 11.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për periudhën e tretë rregullatore,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2012, do të jetë 9.3 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.150, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR TË
LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET
EKZISTUESE ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.5, datë 26.1.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të



licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për periudhën e tretë rregullatore,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese, me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012, do të jetë 7.77 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe të KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.151, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR
NGA “TEC VLORË” SHA TE FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUdhËN E
TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e “Tec Vlora” sh.a., si dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa fikse për aktivitetin e prodhimit të “Tec Vlorë” sh.a., për vitin 2012 të jetë 1,211 mijë lekë MW/muaj.

2. Tarifa variabël e shitjes së energjisë elektrike të KESH sh.a. të jetë 21.4 lekë/kWh.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Tec Vlorë” sh.a. dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 31.1.2012

Doli nga shtypi më 2.2.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë